
AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
KRUDDO SH. P. K

AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

KRUDDO SH. P. K

Sot, në Tiranë, më 01/03/2025, anëtarët themelues:

1. **Z. Muhammed Hanifi Kulaksiz**, shtetas turk, lindur në Esenyurt, Turqi më datë 01/08/1981, i identifikuar me nr personal 24301987228, me numër pasaporte U26030894, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Anvar Mufazalov**, shtetas kazak, lindur në Kazakistan më datë 06/07/1989, i identifikuar me nr personal 890706300031, me numër pasaporte N15070435, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë ranë dakord për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar KRUDDO me kushtet e mëposhtme.

KREU I

Themelimi, Selia, Objekti, Kohëzgjatja

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e këtij Statuti të Shoqërisë dhe Akti Themelimi.
- 1.2 Emri i shoqërisë është **KRUDDO SHPK**. (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Themistokli Gërmenji Pallati Helios Nr 5 Shkalla Nr 2 Kati 4 Ap Nr 10.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme.

Neni 3

Objekti

3.1 Objekti i Shoqërisë është si më poshtë:

Konsulenca informatike. Ofrimi i shërbimeve të ndryshme informatike në fushën e teknologjisë së informacionit. Konsulenca në lidhje me aplikimin e teknologjisë së informacionit në fusha të ndryshme. Zhvillimi dhe shitja e programeve kompjuterike për përdorim në fusha të ndryshme. Ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të shërbimeve të konsulentëve teknikë në fushën e teknologjisë së informacionit, të shkëmbimit dhe shpërndarjes së informacionit, të përpunimit të të dhënave, shërbimet Solution Design për software aplikative; menaxhimi i shërbimeve të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave perkatese; shërbime suporti dhe mirëmbajtje të teknologjisë së informacionit, shërbime të adoptimit dhe përshtatjes së softwareve. Krijim paketa programesh për fusha të ndryshme, animacion i kompjuterizuar dhe shërbime të tjera software. Studime, informime, keshillime për probleme të informatikës, të drejtimit ekonomik financiar dhe administrimit për ndërmarrje, banka, institucione etj. Importimi dhe shitja me shumicë dhe pakicë e hardware-ve për përdorim në fushën e teknologjisë së informacionit; tregtim, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike, informatike, të aparturave teknikë të telekomunikacionit; projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie, Web-site etj. Tregtia me shumicë e pajisjeve të informacionit dhe teknologjisë së komunikimit (ICT). Tregtia me shumicë e kompjuterave, pajisjeve periferike të kompjuterave dhe programeve, riparimi i kompjuterave dhe artikujve personale dhe familjare, riparimi i kompjuterave dhe pajisjeve të komunikimit, riparimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike etj. Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software, shitje license software dhe shërbimeve perkatese të lidhura me to; dhenia me qera e softwareve. Ofrimi i Software si shërbim, programim dhe zhvillim të aplikacioneve Web- based. Auditim i sigurisë së sistemeve informatike, zhvillim dhe hostim i faqeve të aplikacioneve. Dizënjimi, programimi, zhvillimi, konsulence, shërbime dhe veprimtari në fushën e aplikimeve GIS dhe WebGIS, punime hartografike, topografike, dhe fotogrametrike, menaxhim i fotove ajrore dhe ortofotove, rrjetet e infrastruktures, pasuri të paluajtshme, prodhim dhe menaxhim i informacioneve gjeografike dixhitale të të gjitha tematikave, strukturim dhe krijim i bazave të të dhënave hapësinore, zhvillime analizash. Aktivitet i veçantë i shoqërisë. Shërbime të teknologjisë së informacionit, programacion, keshillim dhe aktivitete të tjera informatike - program me përshkrim, modifikim, testim dhe mbështetje të sistemeve të planifikimit të hartimit që integrojnë hardware kompjuterike, teknologji të programeve dhe të komunikacionit on-site organizim dhe punën e klienteve të sistemeve kompjuterike dhe /ose lehtësira të përpunimit të të dhënave dhe aktivitete të tjera të lidhura profesionalisht dhe teknikisht me kompjuterat. Aktivitete të programimit informatik, ku përfshihen, baza e të dhënave, faqet web, adaptim software. Aktivitete të keshillimeve informatike, ku përfshihen, shitjen e hardware ose



software, instalimin (konfigurimi) e kompjuterave personale. Aktivitete te menaxhimit te instalimeve informatike - sherbimin e sigurimit te menaxhimit te sistemeve informatike dhe /ose trajtimi i te dhenave te klienteve, si edhe sherbime te asistences te lidhura me to. Sherbime te tjera te teknologjise se informacionit, ku perfshihen, rikuperimi i problemeve informatike, instalimi i software. Aktivitete te sherbimit te informacionit - aktivitetet e portave te kerkimit ne web, perpunimi i te dhenave dhe aktivitete te mbajtjes (hosting), si edhe aktivitete te tjera me objekti kryesor furnizimi me informacion. Sherbime te funksionimit te portave web, ku perfshihen funksionimi i web siteve, qe japin permbajtje te perditesuar periodike etj. Ofrimi i sherbimeve te keshillimit

per biznes dhe keshilla te tjera per manaxhimin nepermjet, dhenies se keshillave, udhezimeve dhe asistencen operative ndaj bizneseve dhe organizatave te tjera mbi marrredheniet publike, si planifikimi strategjik dhe organizimi, marrjen e vendimeve te natyres financiare, objektiva marketingu dhe politika, politikat e burimeve njerezore, praktikat dhe planifikimin, programimin e prodhimit dhe planifikimin e kontrollit. Menaxhimi i funksioneve te burimeve njerezore, kryerjen e nje game te gjere te funksionimit te burimeve njerezore dhe te menaxhimit te personelit. Instalimi i kamerave, sistemeve te aksesit dhe sistemeve te alarmit. Kompania mund te kryeje cdo veprimtari qe lejohet me ligj ne Republiken e Shqiperise.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërise do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 5 **Ngritja e degëve apo filialeve**

5.1 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë apo filiale brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Shoqërisë.

5.2 Ngritja, organizimi dhe funksionimi i tyre do të kryhet sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe do të zbatojë të gjitha detyrimet ligjore dhe rregullatore të aplikueshme.

5.3 Administratori ka të drejtë të propozojë hapjen e degëve apo filialeve, por vendimi përfundimtar merret nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.



KREU II

Kapitali dhe organet drejtuese

Neni 6

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributet e ortakëve themelues në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në dy kuota, secila me vlerë nominale prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

6.2 Ortakët e shoqërisë janë:

- a. **Z. Muhammed Hanifi Kulaksiz**, shtetas turk, lindur në Esenyurt, Turqi, më datë 01.08.1981, i identifikuar me numrin personal 24301987228 dhe numrin e pasaportës U26030894, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 50% të kapitalit, me një vlerë nominale prej 50,000 lekësh.
- b. **Z. Anvar Mufazalov**, shtetas kazak, lindur në Kazakistan më datë 06.07.1989, i identifikuar me numrin personal 890706300031 dhe numrin e pasaportës N15070435, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 50% të kapitalit, me një vlerë nominale prej 50,000 lekësh.

6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e shoqërisë:

Neni 7

Organet Drejtuese

7.1 Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- a. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve** – organi më i lartë vendimmarrës, i cili përbëhet nga të gjithë ortakët dhe ushtron kompetencat e tij në përputhje me Statutin dhe ligjin në fuqi.
- b. **Administratori** – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë, përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e saj të përditshëm.

7.2 Administrimi dhe Përfaqësimi i Shoqërisë:

- a. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Z. Liridon Vruzhaj**, i biri i Flamurit, lindur më 03.03.1987 në Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar me kartën e identitetit me numër



7.3 Mandati dhe Kompetencat e Administratorit:

- a. Afati i ushtrimit të funksionit të administratorit do të jetë pesë (5) vjet, me të drejtë riemërimi ose shkarkimi sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- b. Administratori ka kompetenca të plota për menaxhimin e përditshëm të shoqërisë, përfaqësimin e saj para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhëniet me të tretët.
- c. Administratori ka të drejtën të firmosë kontrata, të kryejë transaksione financiare dhe të ndërmarrë veprime të tjera të domosdoshme për funksionimin e shoqërisë, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- d. Administratori është i detyruar të raportojë periodikisht para Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mbi gjendjen financiare dhe veprimtarinë e shoqërisë.

7.4 Kufizimet e Administratorit:

- e. Administratori nuk mund të marrë vendime për rritjen e kapitalit, ndryshimin e strukturës së ortakëve apo shitjen e pasurive të shoqërisë, pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- f. Në rast të shkeljes së detyrimeve ligjore apo statutore, administratori mund të shkarkohet nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 8

Asambleja e përgjithshme

8.1 Vendimmarrja dhe Përbërja e Asamblesë

- a. Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në mbledhjet e saj të rregullta ose jashtëzakonshme, sipas dispozitave të Statutit dhe ligjit në fuqi.
- b. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblesë, duke disponuar një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit themeltar që zotëron.

8.2 Thirrja e Mbledhjeve

- a. Orakët lajmërohen me shkrim, së paku 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.
- b. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja, si dhe rendin e ditës.



- c. Lajmërimi bëhet nga administratori. Në mungesë të tij, një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kuotave të kapitalit themeltar, mund ta bëjnë lajmërimin nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar administratorit.
- d. Në rast se administratori refuzon ose nuk fillon procedurën për thirrjen e mbledhjes, ortakët që kanë kërkuar mbajtjen e Asamblesë kanë të drejtë të organizojnë vetë lajmërimin e të tjerëve, duke respektuar procedurat e përcaktuara në këtë nen.

8.3 Vlefshmëria e Vendimeve në Rast Njoftimi Parregull

- a. Nëse Asambleja thirret në mënyrë të parregullt, vendimet e saj do të jenë të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët shprehin dakordësinë për marrjen e vendimeve, pavarësisht nga parregullsia e njoftimit.

8.4 Frekueshmëria e Mbledhjeve

- a. Asambleja e Ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda tre (3) muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore, ose sipas rasteve të parashikuara në ligj.

8.5 Vendi i Mbledhjeve

- a. Mbledhjet organizohen në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër, i cili njoftohet paraprakisht të gjithë ortakëve.

8.6 Procedura e Vendimmarrjes

- a. Në mbledhjet e Asamblesë, vendimet merren me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, përveç rasteve kur ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" parashikon ndryshe.
- b. Në rast se Asambleja vendos për:
 - a. Ndryshimin e Statutit;
 - b. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
 - c. Për të kaluar në likuidim të parakohshëm shoqërinë, ose për zgjatjen e afatit operativ;
 - d. Shpërndarjen e fitimeve,
 - e. atëherë vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat (3/4) të kuotave të kapitalit themeltar.

8.7 Ushtrimi i Të Drejtave në Raste të Shoqërisë me një Vetëm Ortak

- a. Në rastin kur shoqëria është e përbërë nga vetëm një ortak, të drejtat e Asamblesë ushtrohen nga ortaku i vetëm.



Neni 9

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

9.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është kompetente për marrjen e vendimeve strategjike për shoqërinë, duke përfshirë çështjet e mëposhtme:

- a. Ndryshimi i Statutit – Miratimi ose ndryshimi i dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- b. Emërimi dhe Shkarkimi i Administratorëve – Vendimmarrja për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve që menaxhojnë shoqërinë.
- c. Emërimi dhe Shkarkimi i Likuidatorit dhe Audituesve Ligjorë – Përzgjedhja dhe largimi i likuidatorit (nëse aplikohet) dhe audituesve ligjorë në përputhje me ligjin në fuqi.
- d. Përcaktimi i Shpërblimeve – Vendorsja e shpërblimeve për administratorët, likuidatorin dhe audituesit ligjorë.
- e. Mbikëqyrja e Politikave Tregtare – Mbikëqyrja dhe zbatimi i politikave tregtare nga ana e administratorëve, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve për ecurinë e veprimtarisë.
- f. Miratimi i Pasqyrave Financiare dhe Raporteve – Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë të shoqërisë.
- g. Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit – Vendimmarrja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë, përfshirë rritjen ose reduktimin e tij.
- h. Pjestimi dhe Anullimi i Kuotave – Vendorsja për pjesëtimin e kuotave të kapitalit dhe anulimin e tyre, sipas nevojës.
- i. Përfaqësimi në Procedurat Gjyqësore – Vendorsja për përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera ndaj administratorëve.
- j. Riorganizimi dhe Prishja e Shoqërisë – Vendimmarrja për riorganizimin struktural ose, në rastin ekstrem, për prishjen e shoqërisë.
- k. Miratimi i Rregullave Proceduriale – Miratimi i rregullave proceduriale për mbledhjet e asamblesë.
- l. Çështje të Tjera – Vendime për çështje të tjera të parashikuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” apo sipas dispozitave të Statutit.

Neni 10

Përfshirja nga e Drejta e Votës



10.1 Kufizimi i të Drejtës së Votës

- a. Një ortak nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme nëse gjatë mbledhjes merren vendime që lidhen me:
 - a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. Shuarjen e ndonjë detyrimi që është ngarkuar mbi të;
 - c. Ngritjen e një padije kundër tij nga ana e shoqërisë;
 - d. Dhënien (ose mosdhënien) të përfitimeve të reja.

10.2 Përfaqësimi nga një Përfaqësues i Autorizuar

- a. Kur një ortak vendos të ushtrohet përmes një përfaqësuesi të autorizuar, përfaqësuesi konsiderohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi si ortaku që përfaqëson, duke iu zbatuar të njëjtat kufizime lidhur me të drejtën e votës.

Neni 11

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

11.1 Zmadhimi i Kapitalit:

- a. Kapitali i shoqërisë mund të rritet përmes nënshkrimeve të kapitalit, që mund të realizohen me kontributet në para, ashtu edhe me kontributet në natyrë.
- b. Për kontributët në natyrë, sipas kërkesës së administratorit, gjykata emëron një Auditues Ligjor i pavarur, i cili vlerëson kontributet duke u bazuar në standardet e kontabilitetit dhe metodologjitë e pranueshme ndërkombëtare. Kjo procedurë siguron që çdo rritje e kapitalit të justifikohet në mënyrë objektive dhe transparente.
- c. Vendimet për rritjen e kapitalit, përfshirë nënshkrimet e reja, duhet të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në përputhje me dispozitat e Statutit dhe legjislacionin përkatës. Kjo do të garantojë respektimin e parimit të barazisë midis të gjithë ortakëve.

11.2 Kufizimet e Angazhimit të Ortakëve:

- a. Në asnjë rast shumica e ortakëve nuk mund të detyrojnë një ortak individualisht për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- b. Ky dispozitë mbron lirinë kontraktuale dhe financiare të çdo ortak, duke siguruar që çdo vendim për investim shtesë të merret vetëm me vullnetin e lirë dhe të informuar të palëve të përfshira.

11.3 Zvogëlimi i Kapitalit:



- a. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila merr vendim në përputhje me kushtet e përcaktuara për ndryshimin e Statutit të shoqërisë.
- b. Procesi i zvogëlimit të kapitalit mund të realizohet përmes reduktimit të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit ose nëpërmjet reduktimit të numrit të pjesëve, në varësi të vendimit të marrë.
- c. Në të gjitha rastet, zvogëlimi i kapitalit prek të gjithë ortakët në mënyrë proporcionale, duke u bazuar në pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin shoqërisë.

11.4 Procedurat e Dokumentimit dhe Miratimit:

- a. Çdo veprim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit duhet të dokumentohet me kujdes dhe të mbështetet nga raportet e Audituesit Ligjor, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe dokumentacioni tjetër relevant.
- b. Dokumentacioni i plotë dhe i përditësuar duhet të ruhen në regjistrat zyrtarë të shoqërisë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe për qëllime auditimi.

11.5 Procedurat e Dokumentimit dhe Miratimit:

- a. Të gjitha ndryshimet në kapitalin shoqërisë do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet e transparencës, garantimi i drejtësisë dhe mbrojtjes së interesave të të gjithë ortakëve.
- b. Palët do të njoftohen menjëherë për çdo ndryshim dhe do të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutimet dhe vendimmarrjet që lidhen me zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit.

NENI 12

Transferimi i kapitalit

12.1 Burimet e Transferimit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, së bashku me të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitojnë ose transferohen përmes:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b. Shitblerjes,
- c. Dhurimit,
- d. Trashëgimisë,
- e. Dhe çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.



12.2 Lehtësia e Transferimit

- a. Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në Statut.
- b. Pjesët e kapitalit themeltar janë gjithashtu të lehtësisht transferueshme përmes trashëgimisë, duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

12.3 Kushtet dhe Procedurat e Transferimit

- a. Çdo transfer i kuotave të kapitalit duhet të kryhet sipas procedurave të parashikuara në Statut dhe me respektimin e kërkesave ligjore.
- b. Në rast se ndonjë transfer nuk përputhet me dispozitat e Statutit, atëherë ky transfer konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të ketë efekt juridik.
- c. Në rast të transferimit përmes trashëgimisë, kryhen të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e të drejtave dhe obligimeve të trashëguarit sipas legjislacionit në fuqi.

12.4 Njoftimi dhe Regjistrimi

- a. Pas çdo transferimi, ndryshimet në strukturën e kapitalit duhet të njoftohen dhe regjistrohen sipas kërkesave të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe rregulloreve përkatëse.
- b. Të gjitha dokumentet dhe kontratat që lidhen me procesin e transferimit duhet të ruhen për qëllime arkivimi dhe auditimi..



KREU III

Viti Financiar dhe Audituesit Ligjorë

NENI 13

Viti Financiar

13.1 Përcaktimi i Vitit Financiar:

- a. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
- b. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

13.2 Pasqyrat Financiare:

- a. Administratori është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare, të cilat formulohen në përputhje me ligjin mbi kontabilitetin.
- b. Pasqyra financiare duhet të reflektojë saktësisht veprimtarinë ekonomiko-financiare të shoqërisë dhe të përgatitet për miratim nga Asambleja e Përgjithshme.

13.3 Përdorimi i të Ardhurave Neto:

- a. Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto të shoqërisë, si dhe për përdorimin e tyre në përputhje me strategjinë e përgjithshme dhe nevojat operative të shoqërisë.

NENI 14


Audituesit ligjorë

14.1 Emërimi – Audituesi ligjor i shoqërisë emërohet në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 dhe legjislacionin në fuqi, për çdo vit financiar.

14.2 Detyrat – Audituesi ligjor kontrollon pasqyrat financiare, siguron përputhshmërinë me standardet e kontabilitetit dhe paraqet raportin përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

14.3 Pavarësia – Audituesi duhet të jetë i pavarur nga administratori dhe ortakët, duke shmangur çdo konflikt interesi.

14.4 Ndryshimi – Audituesi mund të zëvendësohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



KREU IV

Konfidencialiteti, Prishja & Riorganizimi i Shoqërisë

NENI 15

Ruajtja e Sekretit

15.1 Detyrimi për Konfidencialitet

- b. Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë, duke mos zbuluar informacione të brendshme që mund të dëmtojnë interesat e saj.

15.2 Përgjegjësia e të Punësuarve dhe Drejtuesve

- a. Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë, duke mos zbuluar informacione të brendshme që mund të dëmtojnë interesat e saj.

15.3 Zbatimi i Dispozitave Ligjore

- a. Ky detyrim mbetet në fuqi edhe pas largimit të ortakëve, të punësuarve ose drejtuesve nga shoqëria dhe zbatohet në përputhje me ligjin dhe Statutin e Shoqërisë.

NENI 16

Prishja dhe Likuidimi

16.1 Caktimi i Momenteve për Prishje ose Shpërndarje

- a. Shoqëria mund të prishet ose të shpërndahet në çdo kohë, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - i. Kur përfundon afati i parashikuar në aktin themelues;
 - ii. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - iii. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - iv. Nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy (2) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - v. Me vendim të gjykatës.

16.2 Procedura e Likuidimit

- a. Në rast prishjeje apo shpërndarjeje, ortakët marrin një vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë. Ky vendim përfshin:



- a. Caktimin e një ose disa likuidatorëve, të cilët do të kryejnë procedurat e likuidimit;
- b. Shënohen në çdo dokument i nxjerrë nga shoqëria emri i likuidatorëve dhe shtohet emërtimi "Shoqëri në likuidim e sipër".

16.3 Pasojat e Prishjes

- a. Prishja e shoqërisë tregtare rezulton në hapjen e procedurave të likuidimit, në kushte që shoqëria të jetë në gjendje të aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4 Kryerja e Likuidimit

- a. Likuidimi realizohet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët sipas vendimit të marrë.

16.5 Mungesa e Vendimit për Likuidues

- a. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes së shoqërisë, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për caktimin e një likuiduesi.

NENI 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 17.1 Shoqëria ka mundësinë të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me shoqëri të tjera ose ndarjes së saj në entitete të veçanta, në bazë të vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve. Ky proces kryhet në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe synon:

a. Bashkimin:

Shoqëria mund të bashkohet me një ose më shumë shoqëri të tjera në mënyrë që të formohet një entitet i përbashkët ekonomik. Ky bashkim mund të realizohet në forma të ndryshme (p.sh. bashkim, fuzioni, integrim), sipas kritereve dhe procedurave të vendosura nga ligji dhe Statuti. Vendimi për bashkim merret duke pasur parasysh vlerësimin e avantazheve strategjike, ekonomike dhe financiare që ofron bashkimi për të gjithë palët e përfshira. Procesi i bashkimit përfshin, ndër të tjera, përcaktimin e marrëveshjeve mbi ndarjen e përgjegjësisë, të drejtave dhe obligimeve, si dhe harmonizimin e strukturës organizative të re të formuar.

b. Ndarjen:

Shoqëria mund të ndahet në pjesë të veçanta, ku çdo pjesë merr një identitet juridik të pavarur, në rastet kur kjo veprimtari shërben për rritjen e efikasitetit operacional ose për



realizimin e strategjive të reja të zhvillimit. Ndarja kryhet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve dhe duhet të respektojë dispozitat e ligjit në fuqi, duke siguruar barazi dhe mbrojtje për të gjitha palët. Në këtë rast, procedurat për ndarje përfshijnë përcaktimin e kuotave të kapitalit të ndarë, alokimin e burimeve, ruajtjen e të drejtave të ekzistuar të ortakëve dhe adaptimin e strukturës organizative për të përmbushur kërkesat e reja operative.

c. Procedurat dhe Transparenca:

Proceset e bashkimit dhe ndarjes janë të ndjekura nëpërmjet një kornize të qartë ligjore dhe procedurale që siguron transparencë dhe llogaridhënie në çdo hap të procesit. Vendimet për riorganizim duhet të merren me konsultim të plotë të të gjitha palëve të përfshira dhe pas analizave të detajuara financiare, juridike dhe strategjike. Gjithashtu, para se të implementohen, këto vendime do të dokumentohen në mënyrë të qartë dhe do të njoftohen tek institucionet përkatëse për regjistrim dhe arkivim.

d. Qëllimi Strategjik:

Qëllimi kryesor i këtij riorganizimi është të forcojë pozicionin tregtar të shoqërisë, të rrisë efikasitetin operacional dhe të sigurojë një strukturë të përshtatshme për të përballuar sfidat dhe mundësitë në tregun konkurrues. Proceset e bashkimit ose ndarjes janë projektuar të maksimizojnë sinergjitë ndërmjet entiteteve dhe të përmirësojnë kapacitetet financiare, menaxheriale dhe strategjike të grupit të ri të formuar.


NENI 18

Mosmarrëveshjet

- 18.1** Për çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me zbatimin, interpretimin ose ekzekutimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, kompetenca juridike është caktuar tek Gjykata Shqiptare.
- 18.2** Palët e përfshira janë të detyruara të përpiqen, fillimisht, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore përmes negociatave. Në rast se nuk arrijnë një marrëveshje, mosmarrëveshja do të zgjidhet përmes procedurave gjyqësore sipas dispozitave të ligjit në fuqi.
- 18.3** Ky nen siguron një trajtim të paanshëm dhe transparent të çdo mosmarrëveshjeje, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të të gjitha palëve të përfshira dhe duke promovuar llogaridhënie në zbatimin e dispozitave statutare.

NENI 19

Baza ligjore



19.1 Aktiviteti i Shoqërisë:

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

19.2 Zbatimi i Ligjit Nr. 9901/2008:

Për çështjet që nuk parashikohen ose nuk rregullohen në mënyrë specifike nga ky Statut, zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke përfshirë:

19.3 Akte Ligjore dhe Nënligjore Plotësuese:

Gjithashtu, do të zbatohen edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare dhe çështje të lidhura me to.

NENI 20

Dispozitat përfundimtare

- 20.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua në tre (3) kopje, me vlerë të njëjtë juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 20.2 Një kopje do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për regjistrim dhe administrim sipas ligjit.
- 20.3 Dy kopje do të ruhen në dokumentacionin bazë të shoqërisë, për qëllime arkivimi dhe referimi.
- 20.4 Ky akt themelimi dhe Statut hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët dhe regjistrimit në QKB.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

MUHAMMED HANIFI KULAKSIZ

ANVAR MUFAZALOV

Muhammed KULAKSIZ



Anvar MUFAZALOV

